



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:036827

Datë: 26.04.2023

Numri i dokumentit: 04220690

C – III. – 23 - 0043

Paditësja - Propozuesja e sigurimit:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lagjja, “Lakrishtë”, Prishtinë.

Kundër:

Të paditurit - Kundërshtarët e sigurimit:

G dhe K A nga fshati D i Komunës së Klinës.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), Kolegji në përbërje nga gjykatësit, Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësen, Hajrie Shala dhe gjykatësin, Hasim Sogojeva, antëarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me **dt.26.04.2023**, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET pjerësisht si i bazuar propozimi e paditëses – propozueses së sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit dhe **CAKTOHET** masa e sigurimit dhe **IU NDALOHET**, të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit, G dhe K A nga fshati D i Komunës së Klinës, ndërmarrja e çfarëdo veprimi tjetër të ndërtimit në pjesën e parcelës kadastrale, P –..., ZK D, Komuna e Klinës në sipërfaqe prej 99 m² por edhe në kuadër të sipërfaqes tjetër të përgjithshme prej 69347 m² të parcelës kadastrale, P –..., ZK D, Komuna e Klinës.

II. Masa e sigurisë mbetet në fuqi derisa e njëjta të mos revokohet nga gjykata me aktvendim të veçantë ose me aktgjykim për zgjidhjen e çështjes kryesore.

III. REFUZOHET pjesërisht si i bazuar propozimi e paditëses – propozueses së sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit e më të cilin, ka kërkuar që të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit, G dhe K A nga fshati D i Komunës së Klinës, t’iu ndalohe, marrja çfarëdo veprimi juridik apo shitëblerjes – bartjes së pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërisë lidhur me parcelën, P –..., ZK D, Komuna e Klinës në sipërfaqe të përgjithshme prej 69347 m² .

IV. Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësja – propozuesja e sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë me dt 06.02.2023, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), ka paraqitur padinë kundë të paditurve, G dhe K A nga fshati D i Komunës së Klinës për lirimin e pronës dhe kompensimin e demit material si dhe ka paraqitur edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit e me propozim që të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të paditurve, t’iu ndalohe, marrja e çfarëdo veprimi juridik lidhur me ndërtime apo shitëblerjen – bartjen e pronësisë në persone të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërisë lidhur me parcelën, P –..., ZK D, Komuna e Klinës e me sipërfaqe të përgjithshme prej 69347 m² si dhe që masa e përkohshme e sigurisë mbetet në fuqi derisa e njëjta të mos revokuar me aktvendim të veçantë ose me Aktgjykim meritor të gjykatës së kësaj çështje.

Padisë së saj si dhe he se këtij propozimi, ia ka bashkangjitur, provat gjegjëse : kopjen e certifikatës për njësinë kadastrale, P –... të dt.29.03.2021, ZK, Klinë së bashku me kopjen – skicën e planit të dt.30.03.2021 për ngastrën kadastrale nr.5 – 75, në sipërfaqe prej 1000 m² në emër të K A, kopjen e Vendimit, nr.49/21 të dt.17.03.2021 për referimin e rasti në Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, për lëndën penale, P.nr.239/17, kopjen e marrëveshjes së Ndërmjetësitimit, nr.49/21 të dt.17.03.2021 të arritur në Gjykatën Themelore në Pejë për lëndën penale, P.nr.239/17, kopjen e kërkesës së dt.29.03.2021 së të paditurit, G A të drejtuar AKP-së, Pejë, kopjen e certifikatës për njësinë kadastrale, P –... të dt.29.03.2021, ZK, Klinë së bashku me kopjen – skicën e planit (ortografike) si dhe të skicës të dt.30.03.2021 për ngastrën kadastrale nr...., në sipërfaqe prej 218 m² në emër të G A, kopjen e përshkrimit teknik së bashku me në foto të hartuar nga Mrsc i gjeodezisë, J A së bashku me kopjen e lelëtrnjoftimit të të paditurit, G A dhe kopjen e licencës së ekspertit të gjeodezisë, kopjen e kërkesave të dt.12. tetor 2022 të AKP-së, Zyra Rajonale në Pejë të drejtuar Policisë së Kosovës në Pejë për ndërprerjen e punimeve në pronën e NSH, "Bujqësia" së bashku me kopjet e fotove dhe raportin e vizitës në vend të shoqëruara me fotot e bëra në terren, kopjen e vërtetuar të Raportit Policor të dt.07.11.022 me rastin e shikimit në vend dhe me fotot në vend, kopjen e Amandametit të Rregullorës për shitjen e Aseteve të caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore me

negociim direkt së bashku me ortofotot për ngastrën nr..., ZK D, Klinë, kopjen e raportit të vizitës në terren të dt.26.01.2023 së bashku me fotot.

Me dt.22.02.2023, njëri nga të paditurit – kundërshtarët e sigurimit, K A, ka paraqitur përgjigje në propozimin e paditëses - propozueses së sigurimit, AKP-së mes seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit pasi që të njëjtit, janë obliguar me Urdhrin e kësaj gjykate, C – III. – 23 – 0043 të dt.13.02.2023 e në të cilën në mes tjerash, ka theksuar se e kundërshton në tërësi caktimin e masës së sigurisë sepse e njëjta është pa bazë faktike dhe juridike, se caktimi i saj, është i pa nevojshëm sepse kjo prone, evidentohet si prone shoqërore, NSH, "KBI, "Bujqësia", Pejë dhe se të paditurit apo kundërshtarët e sigurimit, nuk kanë mundësi apo e kanë të ndaluar me Ligjet në fuqi çfarëdo shitëblerje, ndryshim të regjistrave të paluajthmërive në kadastrë apo lënien peng të kësaj njësie kadastrale, e për t'i kryer këto veprime patundëshmëria duhet të jetë formalisht në pronësi të të paditurve, çka nuk është, se sa i përket ndërtimit të objektit në foto të dorëzuara nga pala paditëse, apo propozuesi, është e vërtetë që ky objekt është ndërtuar nga K A, meqenë se AKP-ja, ka bërë kundërshtim, i njëjti premtan që nuk do të ndërmarrë asnjë veprim apo të vazhdoj me ndërtimin deri sa të përfundoj procedura gjyqësore, se K A, ka bërë marrëveshje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit tek ndërmjetësuesi i livencuar që të paguaj qiranë që ka ekzistuar në këtë njësi kadastrale e po ashtu me këtë marrëveshje palët janë pajtuar që për objektin që është aty dhe për 10 ari apo 1,000 m², të kësaj njësie, K A, të bëjë kërkesë për të hyrë në negociim direkt që t'i blej këta 1000 m² nga njësia 5 – 75, ZK Doolovë, se me këtë marrëveshje e cila është lidhur me dt.17.03.2021, Agjencinë Kosovare e Privatizimit, ka marrë për obligim që brenda 90 ditësh të përfundoj procedurën e negociimit direkt, por edhe pasi që i paditur, K A, me dt.29.03.2021, ka bërë kërkesë për negociim direkt, Agjencia nuk ka dhënë kurrë farë përgjigje, se që nga viti 2000 e deri më tani, K A, ka paguar qiranë e këtyre 1000 m² dhe i është përmbajtur marrëveshjes ndërsa AKP-ja, nuk i është përmbajtur, dhe se sipas Rregullorës së dt.30.01.2019, K A, i plotëson kushtet që të blej me negociim direkt këta 10000 m² nga njësia 5 – 75, ZK D, dhe se i ka propozuar gjykatës që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë i Agjencinë Kosovare e Privatizimit dhe se kësaj përgjigje ia kanë bashkangjitur provat, siç janë: Marrëveshja e ndërmejtësuesit, kërkesa për negociim direkt, dhe urdhërpagesa e bankës për pagimin e qirasë .

Me dt.22.2.2023, Dhoma e Posaçme, me Urdhrin e saj, C – III. - 23 – 0043 të dt.23.02.2023, paditëses - propozueses së sigurimit, AKP-së, ia ka dërguar përgjigjen e të paditurit-kundërshtarit të sigurimit, K A e me provat e bashkangjitura me mundësinë e paraqitjes së përgjigjes ndaj përgjigjes së të paditurit - kundërshtarit të sigurimit në propozimin e paditëses-propozueses, AKP-së për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Me dt.01.03.2023, paditësja – propozuesja e sigurimit, AKP-ja me seli në Prishtinë, ka paraqitur përgjigjen (kundërpërgjigjen) e saj të dhënë në përgjigjen e të paditurit – kundërshtarit të sigurimit, K A nga nga fshati D i Komunës së Klinës e në të cilën i ka kundërshtuar pretendimet e të paditurëti – kundërshtarit të sigurimit si dhe ka theksuar se e njëjta ka interes të lartë juridik të bazuar në autorizimin e saj ligjor e në funksion të administrimit, mbrojtjes së pronës shoqërore dhe aseteve të saj, se bazuar në nenion 61 të Ligjitpr DHPSGJ, ajosi paditëse – propozuese e masës së sigurimit, eka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së saj subjektive si dhe se me mos caktimin e masës së sigurimit, asaj si paditëse – propozuese e sigurimit, do t'i shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm dhe i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar propozimi i propozueses dhe të caktohet masa e

përkohshme e sigurisë si dhe të refuzohet përgjigjja e të paditurit – kundërshtarit të sigurimit e më gjerësisht si në arsyetim të kësaj kundërpërgjigjeje.

Me dt.03.03.2023, Dhoma e Posaçme, me Urdhrin e saj, C – III. - 23 – 0043 të dt.03.03.2023, kundërpërgjigjen (përgjigjen) e paditëses - propozueses së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë të dhënë në përgjigjjen e njërit nga të paditurit - kundërshtarit të sigurimit, ia ka dërguar të të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit, për të dhënë kundërpërgjigje dhe se pranimit të këtij Urdhri nga të paditurit – kundërshtarët e sigurimit, me dt.21.03.2023, të njëjtit, nuk janë deklaruar lidhur me kundërpërgjigjen (përgjigjen) e paditëses - propozueses së sigurimit të dhënë në përgjigjjen e tyre të bërë në propozimin e paditëses – propozueses së sigurimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.

Me dt.03.03.2023, Dhoma e Posaçme, me urdhrin e saj, C – III. – 23 – 0043 të dt.03.03.2023, ka urdhëruar paditësesn – propozuesen e sigurimit që t'a plotësoj propozimin e saj për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit në atë mënyrë që të sjell proven – dëshminë – ekspertizën gjegjëse gjeodezike të ekspertit të gjeodezisë rreth dientifikimit të pjesës së ngastrës kadastrale, P –.... të dt.29.03.2021, ZK, Klinë me sipërfaqe të përgjithshme prej 69347 m², e në të cilën pjesë, të paditurit – kundërshtarët e sigurimit, kanë ndërtuar objektin e më gjerësisht si në këtë Urdhër.

Me dt.13.03.2023, paditësja – propozuesja e sigurimit, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën – përgjigjen e dt.10.03.2023 e në cilën ka sqaruar se ekspertiza e kërkuar nga gjykata, nuk është e mundur të dorëzohet brenda afatit 7 (shtatë) ditor e duke e njoftuar gjykatën se në momentin e parë që e pranojnë ekspertizën të njëjtën, do t'a dorëzojnë në gjykatë e po ashtu lidhur meçështjen se e paditura që ka kërkuar përmes propozimit për masën e siguriës që të mos lejohet kurrëfarë lloj veprimi në ngastrën në fjalë, ka sqaruar se për shkak se ka raste në praktikë kur palët nuk janë pronarë të parcelës, ata kanë ndërmarrë veprime të ndryshme ndaj parcelës duke e shfrytëzuar në mënyrë të pa ligjshme autorizimet që i takojnë vetëm pronarit.

Me dt.27.03.2023, paditësja – propozuesja e sigurimit, i është drejtuar kësaj gjykate me parashtrësën e dt.27.03.2023 e së cilës ia ka bashkangjitur ekspertizën e ekspertit të licencuar të gjeodezisë, R M nga Peja, e sipas së cilës ekspertizë, e në të cilën ka vënë në pah se në kuadër të parcelës e cila është në pronësi të parashtruesit të kërkesës, pra parcelës, nr..., është ndërtuar objekti pa leje me etazhitet P + 0 dhe në sipërfaqe prej 99 m² dhe se pjesë e kësaj ekspertize të gjeodezisë, është edhe dokumentacioni përkatës i matjeve gjeodezike, orto fotot për pronën në fjalë si dhe foto grafitë e bëra në terren për ndërtimin e kryer të shtëpisë nga ana e të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit.

Me dt.28.03.2023, Dhoma e Posaçme, me Urdhrin e saj, C- III. – 23 – 0043 të dt.28.03.2023, të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit, veç e veç, ua ka dërguar parashtrësën e dt.27.03.2023 së bashku me ekspertizën e ekspertit të licencuar të gjeodezisë, R M nga Peja dhe se të njëjtit pas pranimit të këtij urdhri me dt.04.04.2023 deri më tani nuk ka prova se janë deklaruar lidhur me çështjen e ekspertizës së gjeodezisë.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se :” *Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/ padie. 2. Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës e sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim”.* Në rastin konkret, Dhoma e Posaçme, palëve ndërgjyqëse, ua ka dhënë mundësinë si palë, që t’i parashtrojnë qëndrimet e tyre në njërin anë paditësve – propozuesve të sigurimit e në anë tjetër të paditurës – kundërshtares së sigurimit për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim, dhe se paditësit – propozuesit e sigurimit, kanë ngelur pranë propozimit për caktimin e masës së sigurimit derisa e paditura – kundërshtarja e sigurimit, e ka kundërshtuar një propozim të tillë derisa Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurisë me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i ”pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Pas shqyrtimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundimin se :

Propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, pjesërisht është i bazuar kurse pjesërisht është i pabazuar,

Dhoma e Posaçme, sipas formulimit ligjor të cekur më lartë, mund të nxjerr masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofroj prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme derisa në rastin konkret, paditësja – propozuesja e sigurimit, me provat e bashkagjitura padisë dhe propozimit të saj për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e ka provuar se pjesërisht ekzistojnë rrethana të cilat, e bëjnë të besueshëm faktin se dëmi është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm përkitazi me ndërtimin në patundëshmërinë e paditëses – propozuese së sigurimit derisa pjesërisht nuk e ka provuar se ekzistojnë rrethana të cilat, e bëjnë të besueshëm faktin se dëmi është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm përkitazi me mundësinë e marrjes së çfarëdo veprimi juridik apo shitëblerjes – bartjes së pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërisë në patundëshmërinë e paditëses – propozuese së sigurimit nga ana e të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit.

Provat e besueshme

Për të përcaktuar kushtet paraprake rreth miratimit të masës së përkohshme të sigurimit, paditësja – propozuesja e sigurimit, iu është referuar provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e veçmas: kopjes së certifikatës kadastrale për ngastër kadastrale në fjalë, procesverbaleve të hartuara nga Komuna e Klinës – Drejtoria e Inspektoratit për ndërtimin pa leje të të paditurve – kundërshtarëve të sigurimit në pronën e AKP-së, si dhe me Raporti i Vizitës në terren i dt.26.01.2023 të kryer nga vet paditësja – propozuesja e sigurimit, AKP-ja në parcelën gjegjëse e posqërisht, ekspertiza e ekspertit të licencuar të gjeodezisë, R M nga Peja, e sipas së cilës ekspertizë, në kuadër të parcelës e cila është në pronësi të parashtruesit të kërkesës, pra parcelës, nr..., është ndërtuar objekti pa leje me etazhitet P + 0 dhe në sipërfaqe prej 99 m² dhe se Kolegji i kësaj gjykate, konsideron se në mënyrë qartë se paditësja – propozuesja e sigurimit, AKP-ja, e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së saj subjektive që të pranohet propozimi i saj për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit. Pa paragjykuar të vendosjen e kësaj gjykate lidhur pjesën kryesore të kërkesëpadsisë së paditëses – propozueses së sigurimit, e bazuar në dokumentet e paraqitura, për natyrën e pretenduar juridike si dhe mbi atë se a i cenohet e drejta pronësore mbi paluajtshmërinë, nga dokumentet e parashtruara më lartë, me vazhdimin eventual të sërishëm të punimeve nga të paditurit – kundërshtarët e sigurimit në patundëshmërinë gjegjëse e cila është pronë e paditëses – propozueses së sigurimit, para vendimit përfundimtar nga gjykata, të njëjtës, pra paditëses – propozuese e sigurimit, do t'i shkaktohej dëm i pariparueshëm.

Gjykata konstaton se parakushti mbi provat e besueshme, është plotësuar e kjo gjykatë mori për bazë edhe pretendimet e njërit nga të paditurit - kundërshtarit të sigurimit, të bëra në përgjigjjen e tij në propozimin e paditëses – propozueses së sigurimit si dhe përgjigjjen e bërë ndaj përgjigjjes së dhënë nga AKP-ja, se ka premtuar se në ngastrën kadastrale në fjalë, nuk do të ndërmarr asnjë veprim apo të vazhdoj ndërtimin derisa të përfundohet procedura gjyqësore e duke i propozur gjykatës, që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit mirëpo i padituri – kundërshtari e sigurimit, nuk i ka respektuar kërkesat e vazhdueshme të paditëses – propozueses së sigurimit për ndërprejen e punimeve në ngastrën kadastrale, P –..., ZK D, Komuna e Klinës, pronë e ndërmarrjes shoqërore, Kombinatit Bujqësor Industrial (KBI), "Bujqësia" (në likuidim), e me të cilën menaxhon këtu paditësja - propozuesja e sigurimit, AKP-ja.

Dëmi i menjëhershëm

Meqenëse, patundëshmëria në ngastrën kadastrale, P –..., ZK D, Komuna e Klinës me sipërfaqe të përgjithshme prej 69347 m², sipas kopjes së certifikatës kadastrale të dt.29.03.2021 të lëshuar nga Komuna e Klinës – Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër për ngastrën kadastrale, evindetohet në emër të ndërmarrjes shoqërore, Kombinatit Bujqësor Industrial (KBI), "Bujqësia" (në likuidim) e me të cilën menaxhon këtu paditësja – propozuesja e sigurimit, AKP-ja, si dhe se të paditurit – kundërshtarët e sigurimit me mos respektimin e deritanishëm të kërkesave të paditëses – propozueses së sigurimit për ndalimin e punimeve në ngastrën kadastrale në fjalë, konstatimet në terren të bëra nga Komuna e Klinës – Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, se paditësit – kundërshtarët e sigurimit, vazhdojnë të bëjnë punime në patundëshmërinë e paditëses – kundërshtarës së sigurimit, dhe se në ngastrën kadastrale, P –..., nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69347 m², sipas ekspertizës së gjeodezisë veç se është përcaktuar qartë se në këtë nagstër kadastrale, është ndërtuar objekti pa leje me etazhitet, P + 0 dhe atë në sipërfaqe prej 99 m², andaj edhe kjo gjykatë konsideron se propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit, pjesërisht i plotëson kriteret ligjore në frymën e nenit 61 par.1 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në vështrim të shkakimit dëmit të menjëhershëm kurse propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit

pjesërisht nuk i plotëson kriteret ligjore në frymën e nenit 61 par.1 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në vështrim të shkaktimit dëmit të menjëhershëm sepse marrja çfarëdo veprimi juridik apo shitëblerjes – bartjes së pronësisë nga të paditurit – kundërshtarët e sigurimit në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërisë lidhur me parcelën, është e pa mundur që të bëhet nga të paditurit – kundërshtarët e sigurimit, e duke marr për bazë faktin se ngastra kadastrale, P –....., në sipërfaqja e përgjithshme prej 69347 m², evidentohet në emër të NSH-së, Kombinatit Bujqësor Industrial (KBI), "Bujqësia" (në likuidim), e me të cilën menaxhon këtu paditësja - propozuesja e sigurimit, AKP-ja .

Nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 9, dhe nenit 61 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (LDHPGJSK).

Shpenzimet procedurale:

Gjykata vendimin e saj për shpenzimet procedurale dhe se nuk caktohet taksë gjyqësore, e mori në bazë të nenit 62 të Ligjit, nr.04/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (LDHPGJSK) lidhur me nenin 8.2 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 i dt.22.3.2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore sepse paditësja, si institucion shtetëror, nuk është obliguar që të paguar taksën gjyqësore për propozimin për masë të sigurimit pasi që Institucionet shtetërore (lokale dhe qendrore), janë të liruara nga pagesa e taksës gjyqësore siç është në rastin konkret, paditësja – propozuesja e sigurimit, AKP me seli në Prishtinë dhe e njëjta nuk ngarkohet me taksë gjyqësore.

KËSHILLË JURIDIKE: Në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (LDHPGJSK), ankesa kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet me shkrim për Kolegjin e Apelit të DHPGJSK-së dhe atë në afat prej **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2023:036827, 26.04.2023

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Hajrie Shala, Gjykatëse _____

Hasim Sogojeva, Gjykatës _____

Numri i lëndës: 2023:036827
Datë: 26.04.2023
Numri i dokumentit: 04220690